




REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA / PUBLIC OF KOSOVO
AGJENCIJA KUNDËR KORRUPSIONIT
AGENCIJA PROTIV KORRUPCIJE
ANTI-CORRUPTION AGENCY

Dip. 2-D/DPK
Dep. Nr. 03
Dep. Bi-Prot. No. 01-245/14
Nro. 03
Broj stranice 24.01.2014
Nr. pagine 03
Data
Datum
Date



Republika e Kosovës

Republika Kosova - Republic of Kosova

AGJENCIJA KUNDËR KORRUPSIONIT
AGENCIJA PROTIV KORRUPCIJE
ANTI – CORRUPTION AGENCY

DATË/A:	23.01.2014
REFERENC-Ë:	AKK-DPK
PËR/ZA/TO:	Feim HOXHA, Ud - Drejtor i Departamentit Ligjor në Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit
CC:	Veton FIRZI, Sekretar i Përgjithshëm i MKRS
PËRMES/PREKO/THROUGH:	
NGA/OD/FROM:	Hasan PRETENI, Drejtor i Agjencisë kundër Korruptionit
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:	Opinion për trajtimin e konfliktit të interesit

Të nderuar,

Në mbështetje të nenit 5 (paragrafi 1, nën paragrafi 1.12) të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korruptionit dhe nenit 19 (paragrafi 1, nën paragrafi 1.5 dhe 1.6) të Ligjit nr. 04/L-051 për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funksionit Publik, lidhur me kërkesën tuaj me numër protokolli DPKI 03-34/14, Agjencia kundër Korruptionit, ofron këtë:

OPINION

Agjencia kundër Korruptionit ka pranuar kërkesë nga Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit me nr. të protokollit 03/34/14, me datë 10.01.2014 me të cilën është kërkuar nga ne si autoritet kompetent për trajtimin e rasteve të konfliktit të interesit, që të ofrojmë opinion lidhur me çështjen se a ka konflikt interesit në përzgjedhjen e z. Arben Zharku si Drejtor i Qendrës Kinematografike të Kosovës.



Pas shqyrtimit të kërkesës suaj, në pajtim me ligjet në fuqi dhe mandatin e përcaktuar për Agjencinë kundër Korrupsionit (në tekstin e mëtejmë: Agjencia) si dhe duke marrë parasysh të gjitha faktet relevante që i posedojmë në lidhje me këtë rast të dyshuar për gjendje të mundshme të konfliktit të interesit, japid opinionin si në vijim:

Duke marrë parasysh informatat dhe faktet që ka në dispozicion Agjencia, procesi i përzgjedhjes së Drejtorit të Qendrës Kinematografike të Kosovës (në tekstin e mëtejmë: QKK) z. Arben Zharku, shprehimisht nuk është në kundërshtim me dispozitat e Ligjit nr. 04/L051 për Parandalimin e Konfliktit të Interesit, dhe në këtë fazë nuk ka elemente të mjaftueshme që mund të argumentojnë faktin se përzgjedhja e Drejtorit të Qendrës Kinematografike të Kosovës të kualifikohet si gjendje e konfliktit të interesit.

Agjencia ka marr parasysh edhe ka analizuar me kujdes shqetësimin dhe reagimet e komunitetit të artistëve si dhe subjekteve tjera të përfshira në këtë proces, se përzgjedhja e drejtorit në fjalë është në kundërshtim me nenin 17 të Ligjit 04/L051 për Parandalimin e Konfliktit të Interesit, mirëpo me kompetencë konstatojmë se neni 17 i këtij ligji nuk e rregullon çështjen e ngritur nga ta, por ka të bëj me kufizimet për zyrtarët e lartë të cilët pas përfundimit të ushtrimit të funksionit publik, punësohen apo zgjedhen në ato institucione që kanë pasur lidhje me ndërmarrjet publike apo private, në periudhën dy vjeçare para përfundimit të ushtrimit të funksionit publik.

Rrjedhimisht, bazuar në gjendjen reale dhe mbi bazën e fakteve të analizuara, si dhe duke u mbështetur në dispozitat e Ligjit 04/L051 për Parandalimin e Konfliktit të Interesit dhe me Ligjin nr. 2004/22 për Kinematografinë, konstatojmë se përzgjedhja e Drejtorit të QKK-së, z. Arben Zharku, pasi ka dhënë dorëheqje nga Këshillit Drejtues i QKK-së, si organ drejtues dhe zgjedhja e ti me konkurs publik, nuk konsiderohet si konflikt i interesit, mirëpo në aspektin profesional dhe në cilësinë e autoritetit qendror që ka Agjencia, si institucion që merret me këshillimin e zyrtarëve, institucioneve lidhur me shfaqjen e konfliktit te interesit dhe për çështje të etikës lidhur me to, konsiderojmë se përzgjedhja e të lartpërmendorit në këtë post më tepër ka të bëj me çështje etike. Kjo për shkak se ai paraprakisht mbante pozitën e kryesuesit të Këshillit Drejtues të QKK-së ndërsa tani është zgjedhur Drejtor i QKK-së, pra në të njëjtin institucion ku ka shërbyer edhe më parë.



Në bazë të Ligjit 04/L051 për Parandalimin e Konfliktit të Interesit, ju njoftojmë se z. Zharku është i obliguar që të bëj deklarimin “rast për rast” të interesave private te tij në çdo rast te mundshëm, ndërsa në rastet kur mund të ketë rol përcaktues në një vendimmarrje të drejtpërdrejt në çështje zyrtare, në të cilën ai apo ndonjë anëtar i familjes apo ndonjë person juridik që ka interes financier konsiderohet si vepër penale e paraparë në Kodin Penal të Republikës së Kosovës. Po ashtu deklarimi rast për rast i interesave për zyrtarët e lartë është e rregulluar me nenin 13 (pika 1) ku përcaktohet se: “Çdo zyrtar i lartë gjatë ushtrimit të funksionit të tij publik, në bazë të njohurive të tij dhe në mirëbesim, detyrohet që të bëj vet deklarimin paraprak, rast për rast, të ekzistencës së interesit të tij privat lidhur me vendimmarrjen në një çështje të caktuar, që

mund të bëhet shkak për lindjen e një konflikti të interesit”. Rastet dhe mënyra për deklarimin rast për rast të interesave private janë të parapara në paragrafin 2 dhe 3 të këtij neni. Po ashtu në bazë të këtij Opinioni ju informojmë se ju si Ministri e Kulturës, që e kontrolloni ligjshmërinë e punës edhe të institucioneve të kulturës, jeni të obliguar që të informoni zyrtarin në fjalë që të zbatoj ligjet në fuqi dhe mos të gjendet në situatë të konfliktit të interesit.

Me respekt!

